



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 198, datë 4.3.2015

PËR

**PROCEDURAT E KRIJIMIT, RIORGANIZIMIT DHE MBYLLJES  
SË INSTITUCIONEVE PUBLIKE, OFRUESE TË ARSIMIT  
DHE FORMIMIT PROFESIONAL**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, dhe të neneve 23, shkronja "d", dhe 24, shkronja "a", të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

**I. Dispozita të përgjithshme**

Krijimi, riorganizimi dhe mbyllja e institucioneve publike, ofruese të arsimit dhe formimit profesional, bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet sociale ose me urdhër të titullarit të institucionit shtetëror që ka në varësi institucionin publik ofrues, në rastin e formimit profesional.

**II. Krijimi i institucioneve publike, ofruese të arsimit dhe formimit profesional**

1. Krijimi i institucioneve publike, ofruese të arsimit dhe formimit profesional, bëhet edhe me propozim të pushtetit vendor ose partnerëve socialë. Propozimi shoqërohet me një argumentim për nevojën e krijimit të këtij institucioni dhe angazhimin e përfshirjen e mundshme të partnerëve socialë.

2. Propozimi për krijimin e një institucioni publik, ofrues të arsimit profesional, paraqitet pranë ministrit përgjegjës për çështjet sociale, të paktën, një vit përpara fillimit të vitit mësimor.
3. Institucioni përgjegjës shqyrton propozimet e dërguara, sipas pikës 2 e 3, të këtij vendimi, dhe, nëpërmjet strukturave të tij, konsultohet me njësinë përkatëse vendore dhe partnerët socialë brenda një afati tremujor. Pas konsultimeve, ai vlerëson nëse krijimi i institucionit është në gjendje të përmbushë kriteret e përgjithshme të funksionimit të institucioneve publike, ofruese të arsimit dhe formimit profesional.
4. Institucionet publike, ofruese të arsimit dhe formimit profesional, krijohen:
  - a) mbi bazën e kërkesës së tregut të punës;
  - b) kur ndryshojnë kushtet dhe kualifikimi për kategori të caktuara aftësish;
  - c) në rastin e investimeve të reja, apo teknologjive bashkëkohorë, që kërkojnë aftësi të reja;
  - ç) në raste të tjera, në varësi të politikave të arsimit, formimit dhe punësimit.

### **III. Riorganizimi i institucioneve publike, ofruese të arsimit dhe formimit profesional**

1. Institucionet publike, ofruese të arsimit dhe formimit profesional, riorganizohen:
  - a) për shkak të përmbushjes së disa qëllimeve ose shtimit të disa qëllimeve të tjera formuese;
  - b) kur lind nevoja e një bashkëpunimi më të ngushtë mes institucioneve të arsimit profesional dhe formimit profesional, për rritjen e frytshmërisë së përdorimit të infrastrukturës së tyre;
  - c) për të optimizuar burimet njerëzore, financiare dhe të infrastrukturës;
  - ç) për shkak të domosdoshmërisë së një bashkëpunimi të ri me subjekte të tjera, shtetërore apo private, nëpërmjet praktikave në ndërmarrje e institucione;
  - d) me kërkesë të organeve të njëjësive të qeverisjes vendore, mbi bazën e studimeve të argumentuara;
  - dh) mbi bazën e kërkesës së banorëve të zonës ku ushtrojnë veprimtarinë, për ofrimin e shërbimeve të ndryshme dhe me struktura të reformuara;
  - e) kur vlerësohet nevoja për transferim në një zonë tjetër, për ushtrimin e veprimtarisë;
  - ë) në çdo rast tjetër, në kuadër të zbatimit të reformave në fushën e politikave sociale, të arsimit, formimit dhe punësimit.

2. Shqyrtimi i nevojës për riorganizim bëhet nga institucioni përgjegjës, i cili vlerëson përdorimin në mënyrë më të mirë dhe efektive të burimeve njerëzore, financiare dhe infrastrukturore.
3. Bordet dhe drejtuesit e institucioneve ofruese të arsimit dhe formimit profesional luajnë rol këshillimor në procesin e vlerësimit të nevojës për riorganizim.

#### **IV. Mbyllja e institucioneve publike, ofruese të arsimit dhe formimit profesional**

1. Institucionet publike, ofruese të arsimit dhe formimit profesional, mbyllen kur:
  - a) kanë përmbushur qëllimin për të cilin janë krijuar ose nuk e përmbushin atë;
  - b) nuk sigurojnë ofertë të përshtatshme për kërkesat e komuniteteve dhe tregut të punës;
  - c) frekuentimi nuk e justifikon mbajtjen e tyre.
2. Në çdo rast, institucioni përgjegjës bën konsultime me drejtuesit dhe bordin e institucionit, ofrues të arsimit dhe formimit profesional, njësinë përkatëse të qeverisjes vendore, banorët dhe partnerët socialë.
3. Në rast se vlerësohet nevoja e mbylljes së një institucioni, ofrues të arsimit dhe formimit profesional, parashikohet një periudhë tranzitore, deri në 2 muaj, brenda së cilës duhet të administrohen të gjitha aspektet që preken nga mbyllja.
4. Mbyllja për institucionet publike, ofruese të arsimit profesional, fillon efektet në përfundim të vitit mësimor, ndërsa, për institucionet e formimit profesional, efektet fillojnë me mbylljen e vitit buxhetor.
5. Në urdhrin e mbylljes së institucionit publik, ofrues të arsimit dhe formimit profesional, parashikohen edhe trajtimi i punonjësve, që dalin të papunë, trajtimi i nxënësve/kursantëve, arkivimi i dokumentacionit të institucionit dhe destinacioni i mjeteve monetare e materiale, në përfundim të likuidimit përkatës.
6. Në rastin e mbylljes së një institucioni publik, ofrues të arsimit dhe formimit profesional, institucioni përgjegjës ngre një komision të posaçëm, i cili monitoron gjithë procesin e mbylljes, në përputhje me urdhrin përkatës, si dhe ankimimet që mund të mbërrijnë nga palët e interesuara.

**V. Dispozita Përfundimtare**

1. Vendimi nr.675, datë 25.9.2003, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave të krijimit, organizimit dhe mbylljes së institucioneve të formimit profesional në varësi të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale", shfuqizohet.
2. Ngarkohen institucionet përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional si dhe institucionet e arsimit dhe formimit profesional për njohjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

MINISTRI I MIRËQENIES  
SOCIALE DHE RINISË

ERION VELIAJ

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSMINISTRI

BARDHYLLKA KOSPIRI